

RECENSION PËR LIBRIN “Përsiatje kuranore – koment i 31 ajeteve të Sures “El-Kehf”

Tefsiri, ose komentimi i Kuranit të Madhërishëm është një nga disiplinat kryesore të shkencave islame. Atë e gjejmë të lëvruar në literaturën islame shqipe që në fillimet e saj, nëpërmjet veprave të dijetarëve dhe intelektualëve myslimanë shqiptarë që synojnë të sjellin në gjuhën amtare kuptimet kuranore. Siç dihet, përkthimi i tekstit kuranor konsiderohet një lloj interpretimi i tij, pasi ai përfaqëson përpjekjen njerëzore për të përçuar në gjuhë të ndryshme kuptimin e mesazhit hyjnor të shpallur në gjuhën arabe.

Përtej përkthimeve kuranore, nuk kanë munguar në literaturën shqipe nismat për t’u ofruar dashamirësve të librit islam në gjuhën shqipe komentare të mirëfilltë të Kuranit. Në mesin e tyre spikat “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Kerijmit” e hafëz Ibrahim Dalliut, si vepra e parë dhe më voluminoze e një autori shqiptar në fushën e *tefsirit*. Karakteristikë e saj dhe e komenteve të tjera kuranore nga hoxhallarët shqiptarë është se nuk e përfshijnë gjithë Kuranin, por pjesë të veçanta prej tij. Kjo ndoshta nisur edhe nga fakti se hartimi i një komentit të plotë kuranor është një arritje shumë ambicioze, e cila kërkon përgatitje të lartë në shkencat islame në tërësi, si dhe mjaft kohë e përkushtim.

Në përgjithësi, *tefsiret* e autorëve shqiptarë kufizohen në ato sure apo grup suresh që gjejnë përdorim më të gjerë në përditshmërinë e jetës fetare të një besimtarit, siç janë dhjetë suret e fundit, Xhuzi Amme apo sure si “El-Fatiha”, “El-Mulk”, “El-Kehf” etj.

Pikërisht surja “El-Kehf” është në qendër të një prej punimeve më të fundit në fushën e eksegjzës kuranore në gjuhën shqipe, me autor studiuesin dhe pedagogun e shkencave islame, Dr. Ziber Lata. Libri titullohet “Përsiatje kuranore: Surja El-Kehf (I), Banorët e Shpellës”, botuar në qytetin e Dibrës në vitin 2021. E shtrirë në mbi 270 faqe të formatit A5, vepra trajton vetëm një pjesë të sures “El-Kehf”, 31 ajete, të cilat rrëfejnë atë që në literaturën islame njihet se historia e “banorëve të shpellës”.

Autori parashtron në hyrjen e librit premisën mbi të cilën ngre studimin e tij. Sipas tij, kuptimet kuranore janë të pashtershme dhe, si të tilla, mundësia për zbulimin e tyre në vazhdimësi nuk është mbyllur. Prandaj dhe qasja studimore që ai ka zgjedhur për hartimin e tefsirit të sures “El-Kehf” është në funksion të kësaj premise dhe të synimit që tipar kryesor i trajtimit të mos jetë ripërsëritja, por rileximi.

Kjo qasje bazohet në analizën gjithëpërfshirëse të tekstit kuranor, duke trajtuar gjuhësisht dhe stilistikisht çdo shkronjë, fjalë a fjali kuranore, me qëllimin për të zbuluar domethëniet e mundshme që fshihen tek ato. Njëherësh, autori rreket të analizojë lidhjet e brendshme që ekzistojnë midis elementëve të sures së marrë në shqyrtim, si lidhjet e tyre me ajete në sure të tjera, duke nxjerrë në pah kohezionin dhe plotësinë e udhëzimit kuranor, në funksion të orientimit të gjithanshëm shpirtëror, ideor e material të njeriut në rrugëtimin e tij tokësor drejt jetës së pasosur.

Para se të hyjë në analizën e hollësishme të ajeteve në shqyrtim, autori bën një studim hyrës dhe përmbledhës rreth sures “El-Kehf”, emërtimit të saj, mesazheve dhe mësimëve që ajo përçon, rëndësisë së saj në jetën e besimtarit, si dhe lidhjeve të saj me suret dhe ajetet e tjera të Librit të Shenjtë.

Në përsiatjet e tij rreth titullit të sures, “El-Kehf”, që në shqip përkthehet “Shpella”, studiuesi Lata trajton simbolikën që mbart koncepti i “shpellës” në aspektin islam, ku siç dihet, mesazhi i islamit e ka zanafillën e tij në shpellën “Hira”, në rrethinat e Mekës. Me plot të drejtë autori e përqsas suren “El-Kehf” me shpellën, e cila ofron për udhëtarin strehim dhe siguri nga vështirësitë e rrugëtimin të tij. Kështu, edhe surja në fjalë i ofron besimtarit që e këndon, strehim dhe siguri nga sprovat e rrugëtimin në jetën e kësaj bote.

Në mbështetje të këtij konstatimi, autori thekson se surja “El-Kehf” rrëfen në tërësinë e saj katër histori, të cilat trajtojnë disa nga sprovat kryesore në jetë, gjegjësisht sprovën në fe, sprovën me pasuri, sprovën me dije dhe sprovën me pushtet. Prandaj ai e quan atë si “surja e sprovave jetësore”. Pastaj vëren se, jo rastësisht historia që flet për sprovën në fe, pra ngjarja e “banorëve të shpellës” trajtohet e para në sure, ngase ajo ngërthen në vetvete kuptime kolektive, ndërkohë që historitë e tjera të rrëfyera aty reflektojnë kuptime të sferës personale. Mbështetur në këtë fakt, studiuesi arrin në përfundimin se surja e merr emërtimin e saj nga kjo ngjarje, për të treguar se interesi i përbashkët qëndron mbi atë personal.

Më tej autori orvatet të zbërthejë arsye të tjera të emërtimit të sures me termin “*El-Kehf* / Shpella”, duke analizuar pozitën e saj qendrore në

ritualin e adhurimeve që besimtari kryen gjatë ditës më të rëndësishme të javës për të, ditës së premte. Sipas udhëzimit profetik, rekomandohet që një besimtar të lexojë ditën e premte suren “El-Kehf”, sepse kështu Zoti do ta mbushë atë me dritë deri të premten e javës vijuese. Sipas tij, surja e merr këtë pozitë nga mesazhet madhore që ajo përcjell dhe mbi të cilat një besimtar duhet të meditojë vazhdimisht, sikur të qëndronte i vetmuar në qetësinë e një shpelle, me qëllimin që t’i përvetësojë dhe t’i jetësojë në përditshmërinë e tij.

Konceptin e sures si strehë e sigurt, autori e shtrin edhe në raport me mbrojtjen që siguron leximi periodik dhe zbatimi i mësimëve të sures ndaj sprovës më të vështirë që do t’i paraqitet njerëzimit, mashtrimit të Dexhalit. Ai konkludon se, sa më shumë anashkalohen orientimet kuranore në lidhje me sprovat që shtjellon surja “El-Kehf”, aq më shumë i hapet fusha e veprimit Dexhalit. Dhe anasjelltas, kush i jep vëmendjen e duhur kësaj sureje dhe zbaton mësimet e saj, do ta ketë të qartë vizionin dhe rrugën e veprimit për t’u ruajtur nga dëmi i asaj sprove të madhe.

Në lidhje me mësimet kryesore që përcjell kjo sure, autori e konsideron atë si një platformë për ndryshim, ku secila nga historitë e rrëfyera përfaqëson hapat ose etapat e zbatimit të kësaj platforme. Nëpërmjet një shtjellimi të shkurtër të secilës etapë, ai nxjerr në pah lidhjet e brendshme që ekzistojnë midis pjesëve të ndryshme të sures, sikurse mundohet t’i ilustrojë ato me ngjarje nga realiteti, duke hequr paralele midis tyre dhe etapave të misionit të Profetit Muhamed (a.s.).

Qasjen e parashtruar në studimin hyrës autori e aplikon me sukses në zbërthimin e domethënieve dhe mesazheve që përçon surja “El-Kehf”. Metoda e tij imponon ndalesa të gjata në çdo ajet, por mjeshtëria e shtjellimit dhe bukuritë e të shprehurit kuranor që studiuesi shpalos shkronjë pas shkronje e fjalë pas fjale, duke i lidhur domethëniet me realitetin ku jetojmë, e bëjnë librin që të lexohet me ëndje, nën shtysën e kërshërisë diturore për të përfituar sa më shumë prej tij.